



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.15, datë 20.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, SUBJEKTIT
“XHULIO” SH.P.K, ME VENDNDODHJE, BASHKIA VORË, QARKU
TIRANË**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, subjektit “Xhulio” sh.p.k me vendndodhje, bashkia Vorë, qarku Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Akuiferi aluvial i Tiranë-Laknas-Rinas

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)

-X=474293.21; Y=4590479.84; Z=23 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime industriale në fabrikën e prodhimit të betonit

Prurja e ujit të kërkuar: $Q=0.9$ l/sek

Prurja mesatare vjetore: $Q_{mes}=3.0$ l/sek

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

-X=474328.26; Y=4590499.09; Z=23 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

-X=474371.24; Y=4590509.87; Z=22.5 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=0.2$ l/s

3. Burimi ujqor të përdoret vetëm për qëllimin e kërkuar (për qëllime industriale në fabrikën e prodhimit të betonit), dhe të mos përdoret për larje të inerteve lumore nëse subjekti nuk ka një leje aktive të shfrytëzimit të këtyre të fundit.
4. Subjekti nuk duhet të shfrytëzojë më shumë se sasia e ujit të kërkuar prej 0.9 l/sek, pasi do të rrisë ndikimin në Stacionin e Urës së Gjolës që përdoret për furnizimin me ujë të qytetit të Shijakut.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBV ISHËM

EMILJAN JANI

